





# NJË QYTET PËR KOMUNITETIN


EC MA NDRYSHE  
dhjetor 2015




PUNËTORITË - VIZIONIMET




PERFORMANSAT PUBLIKE




INTERVENIMET ARTISTIKE



EKSPOZITAT



REALIZIMET




## NJË QYTET PË KOMUNITETIN

Prizrenit vazhdon t'i kanoset identiteti! Hapësirat publike të (uzurpuara), mungesa e sipërfaqeve të gjelbra, bllokimi i trotuareve dhe hapësirat pa cilësi mjedisore dhe estetike, vazhdojnë të jenë shqetësime të qytetarëve. Mungesa e transparencës në qeverisje, Prizrenit i ka kushtuar edhe në cilësinë mjedisore dhe urbane, ku shumica e investimeve nuk kanë sjellë ndonjë përmirësim të theksuar në strukturën ekzistuese. Shërbimet publike kanë vazhduar të mos e kenë qytetarin prioritet, duke e tjetërsuar hapësirën e përbashkët, si rezultat i moskujdesit dhe jofunksionalitetit.

Qytetarët janë ata të cilët i japin jetë hapësirave publike. Por, para së gjithash ato duhet të jenë të pranishme në formën më të mirë të mundshme, me mundësi të krijimit të ndërveprimit ndërmjet shfrytëzuesve të të gjitha moshave. Hapësira të gjelbra, me mundësi për ulje, zhvillimit të lojërave dhe leximit e rekreimit, janë disa nga mundësitë që qytetarët ia vlen t'i kenë në qytetin e tyre.

EC Ma Ndryshe përmes nismave të ndryshme ka tentuar që të nxisë idenë mbi ndryshimin e hapësirës publike, gjithmonë duke e pasur vet qytetarin në fokus. EC-i beson që qyteti ofron mundësi të shumta për ta kthyer hapësirën publike në shërbim të qytetarit, ashtu si ai e projektton në mendjen e vet!

Ky parim është reflektuar në performancat publike, punëtoritë dhe vizionimet si dhe iniciativat e tjera të cilat kanë përdorur artin si formë proteste për atë që është duke ndodhur me Prizrenin. Prizreni duhet të ndryshoj në të mirë të qytetarëve!



3

2

6

8

10

1

5

7

11

18

14

13

12

16

9

15

4

17

## PUNËTORITË - VIZIONIMET

- KOMUNË E HAPUR **1**
- HAPËSIRA PUBLIKE BAZHDARHANE **2**
- HAPËSIRA PUBLIKE ORTAKOLL **3**
- MONUMENT I HAPUR **4**
- SHTEGU PËR ÇIKLISTË **5**
- HARTA E BARRIERAVE **6**
- TË RINJTË DHE QYTETI **7**

## PERFORMANSAT PUBLIKE

- KORSI PËR BIÇIKLETA **8**
- GJELBËRIM NË HAPËSIRAT PUBLIKE **9**
- KOMUNË E HAPUR II **10**
- SA M<sup>2</sup> NJË VENDPARKING **11**
- DRUNJ TË PASTËR **12**

## INTERVENIMET ARTISTIKE

- URA E KALTËRT E DASHURISË **13**
- ANALOGJIA INVERZE **14**
- UNË JAM MONUMENT **15**

## EKSPOZITAT

- PRIZRENI PO LULËZON **16**
- NA ISHTE DIKUR NJË PRIZREN **17**


## REALIZIMET

- INFO QENDRA TURISTIKE **18**





# KOMUNË E HAPUR



# KOMU NË E HAPU R

## KOMUNË E HAPUR

Është një vizion për kthimin e hapësirës publike në shërbim të qytetarit. Për të jetësuar këtë vizion, komunës së Prizrenit i është rekomanduar: largimi i menjëhershëm i rrethojës që e pengon qasjen fizike të qytetarit në ndërtesën e komunës dhe hapësirën publike përreth saj; shtimi i hapësirës së gjelbër përreth ndërtesës së komunës për t'i dhënë lagjes ku gjendet ky objekt një oazë për frymëmarrje që i mungon; shpallja e një konkursi publik për t'i ftuar artistët, arkitektët dhe qytetarët tjerë që të konkurrojnë me ide konkrete për të intervenuar në atë hapësirë dhe zbatimi i kësaj qasje edhe në pjesët tjera të qytetit, e sidomos në hapësirat rrethuese të institucioneve.





# HAPËSIRA PUBLIKE BAZHDARHANE





# HAPËSI RA PUBLIKE BAZHD ARHAN E




## HAPËSIRA PUBLIKE BAZHDARHANE

Ky vizionim është një kundërpërgjigje e banorëve ndaj propozimit për ndërtimin e një objekti shumëbanesorë në hapësirën e vetme të lirë të lagjes Bazhdarhane. Në sipërfaqen e destinuar që të jetë park, ata kanë dhënë propozimet e tyre, duke ndihmuar në krijimin e këtij vizionimi i cili i është adresuar organeve komunale. Parku i propozuar synon që të krijojë një gjelbërim izolues nga rruga kryesore, hapësira gjelbëruese dhe rekreuese për banorët, 'vend për të gjithë' si dhe vizura të mira për vizitorët në hyrje të qytetit. Parku i propozuar përmban edhe hapësirën për zhvillimin e tregut, atë të lojërave si dhe të pushimoreve për të moshuar.





# HAPËSIRA PUBLIKE ORTAKOLL



# HAPËSI RA PUBLIK E ORTAK OLL

## HAPËSIRA PUBLIKE ORTAKOLL

Ky vizionim është rezultat i punëtorisë me banorët e lagjes Ortakoll të cilët nuk janë të kënaqur me gjendjen e hapësirës përreth ndërtesës ku jetojnë. Më shumë gjelbërim, më shumë ulëse, zgjerim i hapësirës në afërsi të hyrjes, vendosje e ndriçimit publik, fontanë dhe ujë për ujitje, kanë qenë disa nga kërkesat e tyre. Ata janë ankuar për hapësirën jo-kualitative që i rrethon, praninë e pluhurit, mungesën e hijes dhe mungesën e vendeve për pushim dhe rekreim. Propozimi për ndryshimin e kësaj hapësirë përfshin masterplanin në të cilën është dizajnuar zgjidhja e re funksionale e cila përmban edhe parkingje për çiklistë dhe lojëra për fëmijë.






# MONUMENT I HAPUR



Monument i mbyllur




Hapësirat me potencial  
per zhvillimin e aktiviteve  
ekonomike


Largimi i pengesave fizike  
përreth monumentit

# MONUMENT I HAPUR


## MONUMENT I HAPUR

Ky vizionim ka për qëllim hapjen e diskutimit gjithëpërfshirës publik për heqjen e barrierave fizike dhe krijimin e hapësirave të reja publike përreth monumenteve, si bazë për krijimin e parakushteve për sigurimin e vetëqëndrueshmërisë financiare të monumenteve. Kjo qasje potencialisht ndikon në rritjen e hapësirës së përgjithshme publike në zonën e qendrës së Prizrenit për 43%, të cilat aktualisht janë asete të pa shfrytëzuara nga komuniteti. Vizionimi për hapësirat publike përreth monumenteve historike hap rrugë për mundësinë e zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit kulturor.





# SHTEGU PËR ÇIKLISTË



1 Shtegu në rrethin Ekrem Rexha - Drini, me gjatësi 120 cm brenda rrethit për autotjete i ndarë me shenjëzim horizontal përkatësisht me vijë të ndërprera për shkak të interferencës nga mjetet motorike që hyjnë dhe dalin nga rrethi dhe shenjësisë së bicikletave e cila përsëritet. Qasja në rreth bëhet me anë të katër shtigjeve, tri prej të cilave janë të ngjyrosura me të kuqe për shkak të rritjes së



2 Shtigjet që hyjnë dhe dalin nga rrethi Ekrem Rexha - Drini përveç ndarjes me vijë të ndërprera, gjithashtu ngjyrosen me të kuqe për rritje të dukshmërisë. Shtegu dykahorë që vjen prej rrugës Ukë Bytyqi, për qasje më të lehtë në rreth, njëri krah i shtegut kalon rrugën tërthorazi, ndërsa tjetri zbrit në rrugë përshkak të përfundimit të shtegut në trotuar. Të dy shtigjet e ndara ngjyrosen me të kuqe për shkak të rritjes së dukshmërisë në rrugë me konflikt të lartë.




3 Shtegu në krahun e majtë të rrugës kur gjindet afër vendparkingjeve shënohet me sinjalet e "shtegut të përbashkët" dhe me shirit të ndërprerë për t'ju rritur ndërgjegjësimin vozitësve të mjetëve motorike por edhe çiklistëve që hapira e caktuar shfrytëzohet nga të dyja palët por që përpasi kanë gjithmonë çiklistët. Shiriti i bardhë i ndërprerë afër parkingut ka gjatësi 10 cm.

### VENDPARKINGJET




Mesazhi i shtegut është qartësisht i parashikuar në rrugën Adem Jashari (nga Haxhi Mehmeti) dhe në rrugën Shqipëri e bashkë me rreth të shpirtit të rrugës. Nëse rrethi është i shpirtit të rrugës, është e mundur të bëhet një zgjedhje e rrethit me një gjatësi të 120 cm dhe një lartësi të 80 cm me dimensione të tilla që mund të bëhen të përdorueshme.



### PROBLEME TË TJERA NË RRUGË


Elementi i një rruge të shpirtit në



4 Shtegu i cili vje nga poshtë drejt trekëndëshit në rrugën "Adem Jashari" ndahet në dy krah, ku njëri kalon në krahun e majtë të rrugës për të vazhduar drejt rrugës "Brahim Osmani" kur sërisht kthehet në krahun e djathtë të rrugës për të vazhduar drejt rrugës "Ankara".



5 Shtegu përgjatë kalimit të tërthortë të rrugës ka gjatësi 120 cm për shkak të kthimit më të lehtë në shtegun 80 centimetëresh që vazhdon drejt rrugës "Brahim Osmani". Shënjëzohet me shirit të ndërprerë dhe sinjalit e bicikletave në përsëritje më të madhe për shkak të rritjes së dukshmërisë.



6 Shtegu përgjatë rrugës "Adem Jashari" i gjere 80 cm, i shenjuar me shirit të bardhë me ndërprerje kur rruga nuk përdoret vetëm për çikliste por edhe për mjetet motorike të tjera. Në këto rast ndërpreja nga mjetet motorike që kthehen majtas.

# SHTEGU PËR ÇIKLIST Ë

## SHTEGU PËR ÇIKLISTË

Ky propozim përcjellë porosinë vizuale për promovimin e lëvizjes së lirë të përdoruesve të biçikletave. Hulumtimet e viteve të kaluara kanë nxjerrë si shqetësim të qytetarëve mungesën e shtigjeve për biçikleta në pjesën urbane. Bazuar në këto kërkesa, por edhe dy petitionet e dorëzuara më parë në Komunën e Prizrenit, është realizuar ky vizionim, që shërben si shembull se si mund të duken dhe aplikohen shtigjet për biçikleta në rrugët e qytetit të Prizrenit. Vizionimi shërben edhe si shtytës për fuqizimin e thirrjes për më shumë vëmendje në krijimin e shtigjeve për biçikleta, pasi që edhe ky komunitet duhet ta gëzojë të drejtën që të lëvizë lirshëm dhe në mënyrë të sigurtë në trafik.





1. Mungësi e mëshajve të përmë që do të zvogëlonin lëndimet nga degët nga personat e verbër, me shikim të dobët ose pa të dëmtuar.

2. Shenjat e komunikacionit që janë të vendosura në lartësi të papërshtatshme dhe pengojnë lëvizjen dhe personat e verbër, me shikim të dobët ose pa të dëmtuar.

3. Uj i derdhur në trotuare që shkakton ngjice gjatë dimrit dhe vështirëson kalimin në atë pjesë të rrugës.



4. Projektet e lokaleve afariste.

5. Pjerrina të improvizuara në lokale afariste që nuk mund të përdoren.



6. Fugat e pambushura ndërmjet gurëve në rrugët me kaldërime.

7. Mungësi e zebrave krahas pjerres.

8. Mungësi e pjerres në vendet ku janë zebrat.

9. Pjerrinat e dëmtuara të trotuareve dhe si të tilla të pastrifrytëzueshme.

10. Pjerrinat jashtë standardeve që nuk mund të përdoren.



11. Pamundësi e dasjes në shadërvan, hamam dhe kalanë e Prizrenit.

12. Mungësi e vendeve të rezervuara për parkim për persona me nevojë të veçanta.

13. Veturat e parkuara që ngushtojnë trotuarin.

14. Veturat e parkuara në pjerina që pamundësojnë përdorimin e tyre.

15. Komunikacioni i dendur që paraqet pengesë për të gjithë.

16. Kabinat e telefonit të larta që e vështirësojnë përdorimin nga personat me nevojë të veçanta.



17. Trotuaret e ngushta përgjatë rrugëve.


18. Trotuaret e vazuara.

19. Trotuaret e dëmtuara në pjesë të ndryshme të rrugës.

20. Reklamnat e lokaleve të ndryshme përgjatë rrugës.



TROTUAJET E VALEZUARA



VETURAT E PARKUARA NË TROTUAJE



SHENJAT E KOMUNIKACIONIT NË LARTËSI JO ADEKUATE



KOMUNIKACIONI I DENDUR



TROTUAJI I DËMTUAR



MUNGËSI E ZEBRAVE ATY KU KA PJEERRINA



PJEERRINE E DËFECTIVITATSHME



LARTËSI E MASHË E KABINAVE TELEFONIKË

## BAZHDARHANJA



MUNGËSI E PJEERRINËS




VETURAT E PARKUARA NË PJEERRINE




UJI I DERDHUR NË TROTUAJE



PJEERRINË JO ADEKUATE



MUNGËSI E VENDEVE TË REZERVUARA NË PARKINGUJE




MUNGËSI E FUGAT REZERVUAR NË ZEBRAVE



PAMUNDËSI E DASJES NË SHADËRVAN

## SHADËRVANI

Ndërtesat e trashëgimisë kulturore janë tërësisht të pa qasshme. I gjithë kompleksi i Shadërvanit me ndërtesat e trashëgimisë në të si: Xhamia e Sinan Pashës, Hamami, Kisha e Shen Gjorgje Rrinoviqit, Kisha e Nikollës Tutbëve, Ura e gurit si dhe Xhamia e Sirriut Pashës nuk posedojnë rampa si dhe sinjalizues të tjerë për personat me nevojë të veçanta.





# HARTA E BARRI ERAV E


## HARTA E BARRIERAVE

Hartëzimi i pengesave fizike është realizuar në bazë të analizës së bërë me personat me nevoja të veçanta dhe pengesave që ata kanë hasur përgjatë ecjes nga rrethrotullimi në lagjen Bazhdarhane deri në sheshin Shadërvan. Disa nga pengesat e identifikuar në këtë hartë janë: mungesë e pjerrinave, pjerrina jo adekuate, tortuare të valëzuara dhe të dëmtuara, vetura të parkuara në trotuare, shenja të komunikacionit në lartësi jo adekuate, mungesë e vendeve të rezervuara për parkingje etj. Pas identifikimit të këtyre pengesave, harta i është dërguar qeverisë lokale të Prizrenit me kërkesën për veprime konkrete në eliminimin e këtyre pengesave.





# TË RINJTË DHE QYTETI



# TË

# RINJT

# Ë DHE

# QYTE

# TI

## TË RINJTË DHE QYTETI

Punëtorja "Prizreni...si (s')do të duhej të ishte?!" ka pasur për qëllim që të rinjëve tu krijojë mundësinë të shprehin vizionin e tyre për qytetin, duke i bërë kështu pjesëmarrës në procesin e planifikimit urban. Përmes mjeteve të ndryshme të punës, të udhëhequr në punë grupore, të rinjtë janë stimuluar të punojnë në lokacione specifike duke trajtuar gjendjen reale të pjesëve të caktuar të qytetit, por edhe duke dhënë propozime për situata ideale. Të rinjtë kanë folur për më shumë gjelbrim në qytet, për përfshirje të vendeve për lojra, për praninë e këndeve për lexim si dhe për më shumë kujdes rreth objekteve të trashëgimisë kulturore.





# KORSI PËR BIÇIKLETA



# KORSI PËR BIÇIKL ETA

## KORSI PËR BIÇIKLETA

Dhjetëra çiklistë përmes pedalimit një orësh nëpër qytet, kanë adresuar në mënyrë publike kërkesën për planifikimin e korsive për biçikleta në qytetin e Prizrenit. Grumbullimi i çiklistëve ka nisur në sheshin përballë Xhamisë së Sinan Pashës, me ç'rast nga Ura e Arastës ka nisur edhe xhiroja që ka përkthyer rrugën unazore të qytetit. Pas xhiros së plotë nëpër rrugën unazore të qytetit, çiklistët janë kthyer në Kej, ku edhe kanë nënshkruar peticionin për planifikimin e korsive (shtigjeve) për biçikleta. Kjo performansë i paraprinë vizionimit "Shtigje për Biçikleta", që shërben si shembull se si mund të duken dhe aplikohen shtigjet (korsitë) për biçikleta në rrugët e qytetit të Prizrenit.





## GJELBËRIM NË HAPËSIRAT PUBLIKE



# GJELBË RIM NË HAPËSI RAT PUBLIK E

## GJELBËRIM NË HAPËSIRAT PUBLIKE

Përmes kësaj performanse komuniteti i të moshuarve të Prizrenit ka bërë gjelbërimin e hapësirave në Kejin përballë Xhamisë së Sinan Pashës, që ishte identifikuar nga ta si një hapësirë publike pa gjelbërim të mjaftueshëm. Vizioni për këtë intervenim ka dalë nga punëtorja me të moshuarit, që kishte për qëllim ridizajnimin e kësaj hapësire. Përmes këtij aktiviteti është adresuar kërkesa që gjatë planifikimit dhe investimeve të komunës në hapësirat publike, t'i kushtohet kujdes më i madh gjelbërimit, me qëllim që këto pika më pastaj të shërbejnë për ndërveprim më të madh ndërmjet grupmohave të ndryshme të qytetarëve.





# KOMUNË E HAPUR II





# KOMU NË E HAPUR II

## KOMUNË E HAPUR II

Kjo performansë është vazhdimësi e kërkesës për hapjen e komunës, duke pasur për synim promovimin e lëvizjes së lirë në hapësira publike, më shumë hapësira gjelbëruese dhe transparencë në objektet publike. Për ta fuqizuar këtë kërkesë, ky aktivitet në mënyrë simbolike përsërit nevojën për lirim të hapësirës publike nga gardhi rrethues që momentalisht ua pamundëson qytetarëve shfrytëzimin e kësaj hapësire të përbashkët. Përmes vendosjes së siluetave të individëve të grupeve të ndryshme të komunitetit në gardhin ekzistues, performansa nxjerrë në pah nevojën që qytetarëve t'ju jepet e drejta për depërtim në hapësirën e cila u takon për shfrytëzim.





SA M<sup>2</sup> NJË VENDPARKING



# SA M<sup>2</sup> NJË VENDP ARKIN G?!

## SA M<sup>2</sup> NJË VENDPARKING

Hulumtimet e viteve të kaluara kanë nxjerrë si shqetësim kryesor të qytetarëve bllokimin e trotuareve me automjete. Bazuar në këto të gjetura, në sipërfaqen e një vendparkingu 2,5m X 5m është inskenuar një dhomë dite. Gjatë ditës në këtë “dhomë dite”, qytetarët kanë ndaluar për të pirë kafe, bashkë me aktivistë nga shoqëria civile, të cilët janë solidarizuar me thirrjen që trotuari të jetë në shërbim të këmbësorëve. Performansa ka shërbyer për fuqizimin e thirrjes për më shumë vëmendje në rastet e bllokimit të hapësirave publike, duke dëshmuar se ajo është qenësore, dhe se është e barasvlershme me një dhomë në të cilën mund të ndodhin shumë nga aktivitetet jetësore.





# DRU NJ TË PAST ËR

## DRUNJ TË PASTËR

Përderisa drunjtë janë atribues kryesor në pastërtinë e ajrit, gjelbërimin dhe hijen e krijuar si dhe janë përbërës të rëndësishëm në peizazhin e qytetit, ata vazhdimisht po përdoren si sipërfaqe reklamuese. Ngjitja dhe shpimi në sipërfaqen e drunjve, ndikon në dëmtimin e tyre. Për të evituar këtë, është propozuar një alternativë e tabelave reklamuese të cilat do të lironin drunjtë nga njoftimet e reklamave. Kjo tabelë do të kishte jo vetëm funksion utilitar, por edhe atë të artit publik. Paralelisht prezantimit të tabelës, në kuadër të performancës është bërë pastrimi i disa drunjve ekzistues, me thirrjen për më shumë kujdes në trajtimin e tyre në të ardhmen.






# URA E KALTËR TE DASHU RISË

## URA E KALTËRT E DASHURISË

Intervenimi artistik “Ura e Kaltërt e Dashurisë” synon ta kthej këtë urë në një pikë atraktive për vizitorët, duke e vënë në fokus rëndësinë e trashëgimisë kulturore dhe shndërrimin e saj në një destinacion turistik, të praktikuar tashmë në shumë vende të tjera. Në rrjetat metalike të vendosura paralelisht me parrakët ekzistues të urës, të dashuruarit do të mund të lidhin simbolikisht zemrat me drynjë të formave dhe dizajnëve të ndryshme. Çelësi i drynjëve me iniciale dhe mesazhe personale do të hidhet në Lumbardhë dhe kështu sipas legjendës, dashuritë do të qëndrojnë të lidhura përgjithmonë mbi “Urën e Kaltërt të Dashurisë”.





# ANALOGJIA INVERZE






# ANALOGJIA GJIA INVERZ E


## ANALOGJIA INVERZE

Realizuar në hapësirën e Kejit, përmes materialeve ricikluese, ky intervenim shpreh pakënaqësinë e qytetarëve për degradimin dhe mos kujdesin ndaj hapësirave publike nga institucionet përgjegjëse. “Analogjia inverze” është revoltë ndaj dinamikës së ndërtimeve në Prizren, sidomos atyre që po e shkatërrojnë qendrën historike, e bashkë me të edhe kujtesën kolektive e cila është shtresuar përgjatë një kohështrirjeje prej mijëra vjetësh qysh nga formimi i qytetit. Shikuar prej një këndi tjetër kjo analogji e kthyer mbrapsht jep porosi përmirësimi për rikonceptimin e një qyteti edhe në aspektin e qasshmërisë. Intervenimi përfshin pjesën revitalizuese dhe atë artistike.





UNË JAM MONUMENT



# UNË JAM MON UMEN T

## UNË JAM MONUMENT

Ky intervenim artistik synon të rikthejë Arastën e vjetër fizikisht, përmes volumetrisë fantome të urës së mbuluar. Forma përmes thjeshtësisë tenton të sjellë në vëmendje një kujtim të mirë të urës së dikurshme, përderisa materiali PVC përmes kompleksitetit në vetvete flet për zymtësinë dhe realitetin e hidhur që po e mbyt qytetin e Prizrenit. UNË JAM MONUMENT është homazh për qendrën që po zhduket, krenarinë e Prizrenit, urat dhe çdo gjë të bukur që kjo pjesë e qytetit dikur strehonte në brendinë e saj, e që sot më nuk i ka. Vepra bën thirrje te institucionet përgjegjëse për të vepruar dhe ruajtur vlerat kulturore të qytetit të Prizrenit.





# PRIZRENI PO LULËZON



# PRIZR ENI PO LULËZ ON

## PRIZRENI PO LULËZON

Ekspozita është një thirrje për veprim të përbashkët dhe njëkohësisht një kritikë ndaj institucioneve të shtetit për veprim dhe jo për retorikë "lulëzuese". Fotografitë e prezantuara tregojnë nivelin e kaosit, degradimit, papastërtisë dhe ngufatjes në të cilën gjenden shumë lagje të Prizrenit, ku qytetarët përballen me mjedis të ndotur, infrastrukturë të pamjaftueshme, zaptim të hapësirës publike dhe rrezikim të sigurisë publike. "Prizreni po lulëzon" përmes inskenimit të gjendjes aktuale në Prizren, bën po ashtu thirrje për veprim qytetar për të shpëtuar qytetin nga kaosi, degradimi, uzurpimi dhe ngufatja...Për ta kthyer imazhin e dikurshëm të Prizrenit!






NA ISHTE DIKUR NJË PRIZREN



## NA ISHTE DIKUR


Ekspozita është përpjekje për të luftuar humbjen e kujtesës kolektive dhe për të apeluar për veprim institucional. "Na ishte dikur..." shfaq fotografitë e vjetra të Prizrenit krahas atyre të realizuara rishtazi nga pozicioni i njëjtë. Ndryshimi është drastik dhe tregon se vetëm disa dekada kanë mjaftuar që struktura urbane e qytetit të transformohet në nivel të frikshëm. Shkatërrimin e nisur para disa dekadash nga regjimi i kaluar, me sukses po e vazhdon qeverisja aktuale. Ekspozita "Na ishte dikur..." është shprehje e revoltës qytetare ndaj shndërrimit të Prizrenit në diçka që askush nuk po e njeh më. Krahasimet dikur dhe sot ilustrjnë këtë realitet të hidhur.



# NA ISHTE DIKUR NJË PRIZR EN



INFO QENDRA TURISTIKE






# INFO QENDR A TURIST IKE

## INFO QENDRA TURISTIKE

Përpos qëllimit primar, mikëpritjen e turistëve, info qendra paraqet një tentim për të ilustruar një qasje ndryshe të intervenimeve në objektet e trashëgimisë kulturore. Si bazë për intervenim është përdorur “kontrasti” si koncept bashkëkohor i ndërhyrjeve në objektet e trashëgimisë kulturore duke krijuar një dallim të qartë në mes të vjetrës dhe të resë, njëkohësisht duke respektuar parimin që çdo intervenim duhet të jetë gjurmë e kohës së vet. Çdo element i ri, qëndron pezull duke e prekur minimalisht të vjetrën dhe duke e respektuar maksimalisht karakterin historik të objektit.





Projektet kryesore të organizatës gjatë viteve të fundit: EC për qytete transparente dhe gjithëpërfshirëse (2015–2016), Indeksi i Reformës së Transparencës Komunale (2015–2016), Urbanizmi I Prizrenit nën vëzhgim të përhershëm (2013–2016), Aktivizmi kulturor dhe urban në Prizren (2014–2015), Qyteti Gjithëpërfshirës, planifikim me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren (2013–2015), Lidhja e komunitetit me shërbyesit e drejtësisë (2014–2016), Zhvillimi rajonal përmes turizmit kulturor (2014–2015), Pjesëmarrja qytetare përmes medias sociale (2013–2015), Trashëgimia kulturore, shtyllë qendrore e zhvillimit lokal dhe rajonal në Prizren (2013–2015), Pjesëmarrja publike në hartimin e politikave kulturore në Prizren (2012–2013), Transparenca Online e komunave të Prizrenit, Mamushës dhe Prishtinës (2012–2015), Një tregim ballkanik (2011–2012), Aktivizmi qytetar për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore (2009–2010).

Publikimet e fundit të organizatës: Zhdukja e Gjurmëve – Qendrat historike të Kosovës (2015), Mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore (kontribut për raportin e Progresit) (2015), (Pa)drejtësia në urbanizmin e Prizrenit (2015), Grupet e komunitetit dhe planifikimi urban në Prizren (2015), Katalogu i Rajonit të Prizrenit (2015), Planifikim urban për qytetarët (2014), Qendra Historike e Prishtinës numëron ditët e fundit (2014), Ku është kalldrëmi i Prizrenit? (2014), Paraja publike si “paret e babës” (2014), Udhëzues për transparencën në komuna (2014), Ligjet nuk po e mbrojnë Qendrën Historike të Prizrenit (2014), Urbanizmi si lexim i qytetit (2014).

## EC MA NDRYSHE

EC është organizatë e komunitetit, e themeluar në vitin 2006, që angazhohet për avansimin e demokracisë në nivel lokal në Kosovë. Organizata punon me një numër të konsiderueshëm grupesh të komunitetit, si dhe mirëmban një presion të përhershëm ndaj qeverive lokale për qeverisje gjithëpërfshirëse, transparente dhe llogaridhënëse.

EC angazhohet për qytetari aktive në formësimin e ambientit jetësor duke nxitur organizim të mirëfilltë të komunitetit, demokratizim të institucioneve dhe pasurim të jetës kulturore në qendrat kryesore të Kosovës, me fokus në Prizren dhe Prishtinë.

Nga janari i vitit 2015, EC funksionon me këto tri programe:

-Qyteti Gjithëpërfshirës (mobilizim i komunitetit) – Mobilizimi i komunitetit përbën thelbin e punës së EC-it. Identiteti i organizatës rrjedh nga angazhimi komunitar. Qyteti Gjithëpërfshirës do të jetë programi më i rëndësishëm i organizatës dhe do të përfaqësojë tiparin dallues të EC-it në raport me organizatat tjera të shoqërisë civile. Pjesë e këtij programi do të jenë veprimet që nxisin aktivizmin qytetar në nivel të grupeve të komunitetit (kryesisht lagjet urbane),

-Qeverisja e mirë (monitorim dhe avokim) –Për t'u siguruar që qeveria lokale vepron në përputhje me kërkesat dhe interesat e grupeve të komunitetit dhe për të mbajtur gjallë presionin publik ndaj autoriteteve, programi i Qeverisjes së Mirë do të strukturohet rreth aktivitetit të monitorimit të transparencës dhe rolit watchdog të organizatës. Monitorimi është një ndër tiparet më dalluese të punës së EC-it, ndërsa ai është dizajnuar në atë formë që do t'i ushqejë dy programet e tjera të organizatës me informacion të bazuar, të shpejtë dhe kredibil.

-Hulumtimi (prodhim i dijes) –Prodhimi i dijes do të jetë një nga sferat e angazhimit të përhershëm të organizatës. Duke ndërtuar mbi produktet e hulumtimit të prodhuara në vitet e fundit, organizata do të ndërtojë një sistem të strukturuar të hulumtimit dhe prodhimit të dokumenteve të politikave. Programi i hulumtimit do të forcojë edhe më tutje kapacitetin prodhues të organizatës dhe do të përmirësojë kompetencën profesionale në fushat e ngushta të angazhimit.

